



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 994/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Prishtinë për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë

Arsyetim

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga LVV me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 gjatë zhvillimit procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve personi me emrin Albert Kastrati i njohur si militant i LDK-së ka vizituar disa qendra të votimit dhe se prania e tij në këto QV dhe nami i tij si person me të kaluar penale bënë të dyshohet se qëllimi i vizitave të tij është ushtrimi i presionit ndaj votuesve, pasi që sipas informatave të parashtruesit të ankesës ky person është nën masë e arrestit shtëpiak dhe se prania e tij dëshmon mosrespektimin e kësaj mase të shqiptuar ndaj tij.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013, në ora 10:00.

PZAP-i, për rastin në fjale nuk pranoi pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK.

Poashtu PZAP-i kërkoi informacione për rastin në fjale edhe nga Policia e Kosovës, por megjithatë nuk pranoi ndonjë informacion për këtë rast.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e LDK-se se militanti i LDK-se Albert Kastrati ka vizituar disa here QV-të, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar nga shkakut se nga veprimet e ndërmara nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar si dhe nga mungesa e ndonjë informacioni nga policia e Kosovës PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 994/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.